

PRANUAR	15/11/2024		
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-060/04-	55171		



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSBB)
IZVEŠTAJ O SASTANKU OPŠTINSKOG ODBORA ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE (OOBZ)

Komuna / Opština: Drenas Data / Datum: 24.10.2024

Numri i takimit për këtë vit / Redni broj sastanka u ovoj godini: 5

Takim i rregullt / Redovni sastanak

Takim i jashtëzakonshëm / Vanredni sastanak

Numri i anëtarëve të KKSBB-së të pranishëm / Broj prisutnih članova OOBZ: 14

A kanë marrë pjesë në takim përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, nëse janë anëtarë të KKSBB-së?

Da li su predstavnici nevećinskih zajednica, u svojstvu članova OOBZ, prisustvovali sastanku?

Po / Da

Jo / Ne

Nuk ka anëtarë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë/Nema članove koji predstavljaju nevećinske zajednice

A kanë marrë pjesë anëtarë të tjerë përveç anëtarëve të KKSBB-së?

Da li je neko osim članova OOBZ prisustvovao sastanku?

Po / Da

Jo / Ne

Nëse "Po", ju lutem potenconi organizatën të cilën e përfaqësojnë

Ukoliko je odgovor "Da", molimo navedite koje organizacije predstavljaju

Përfaqësues të KFOR--it

A është kryesuar takimi nga Kryetari i Komunës apo nënkryetari?

Da li je sastankom predsedavao Gradonačelnik ili Zamenik?

Po / Da

Jo / Ne

Temat në rendin e ditës / Teme na dnevnom redu:

Në mbledhjen e mbajtur me datë 24.10.2024 u diskutuan këto pika të rendit të ditës:

1. Procesverbal i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 15.08.2024: <https://kk.rks.gov.net/glllogoc/procesverbal-i-mbledhjes-se-keshillit-komunal-per-siguri-ne-bashkesi-i-dates-15-08-2024/>;
2. Siguria e përgjithshme në Komunën e Drenasit, informim nga Stacioni i Policisë në Drenas;
3. Dukuria e vetëlëndimit të fëmijëve nga loja e "Tik Tok-ut", masat nga organet përgjegjëse;
4. Raport për trajtimin e qenve endacak në Komunën e Drenasit;
5. Të ndryshme

Ju lutem, potenconi temat tjera për të cilat është diskutuar në të ndryshmet / Molimo navedite druge teme o kojima se diskutovalo:

Konkluzionet / Zaključci:

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) ka mbajtur mbledhjen e pestë (5) për këtë vit ku të pranishëm ishin 14 anëtarë të KKSB-së që përfaqësojnë komunitet dhe organizatat në komunën e Drenasit dhe përfaqësues nga KFOR-i.

1. Procesverbal i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 15.08.2024: <https://kk.rks.gov.net/glllogoc/procesverbal-i-mbledhjes-se-keshillit-komunal-per-siguri-ne-bashkesi-i-dates-15-08-2024/>; U miratua pa ndonjë vërejtje.
2. Siguria e përgjithshme në Komunën e Drenasit, informim nga Stacioni i Policisë në Drenas.
Siguria e përgjithshme është e mirë, pra qetë. Pra, gjatë këtij 9 mujori në Stacionin Policor në Drenas

janë paraqitur 592 raste, 8 raste më pak nga viti i kaluar. Raste të vrasjeve dhe vetëvrasjeve nuk kemi pasur vetëm 1 vdekje të dyshimtë. 208 aksidente, grabitje të rënda e të lehta gjithsej 66 raste. Ndërsa, sa i përket sigurisë në shkolla, 14 raste vepra penale të iniciuara, kurse janë mbajtur 32 ligjërata në shkolla e 18 takime me drejtorë.

3. Dukuria e vetëlëndimit të fëmijëve nga loja e “Tik Tok-ut”, masat nga organet përgjegjëse. Lidhur me këtë dukuri shumë shqetësuese në rrjete sociale në disa komuna, fatmirësisht në Komunën e Drenasit nuk kemi pasur raste të tilla të rinjtë. “Takim kemi mbajtur me drejtorë të shkollave dhe në vazhdimësi mbajmë ligjërata vetëdijësuese, e edhe për këtë temë të motivuar nga rrjetet sociale. Strategjinë për mbrojtjen e fëmijën e kemi përcjell në shkolla, gjithashtu me psikolog dhe me policinë kemi mbajtur ligjërata”, ka njoftuar mes tjerash drejtori i DKA-së, Muhamet Gjoka.

4. Raport për trajtimin e qenve endacak në Komunën e Drenasit. Shaban Mehmeti, veteriner i spitalit për trajtimin e qenve “CityPet Hospital” theksoi se gjendja në Komunën e Drenasit sa i përket trajtimit të qenve është më së miri pasi këto vitet e fundit është punuar shumë në këtë aspekt. “Sipas kontratës kemi arritur në vitin 2021 të trajtojmë 653 qenë, ndërsa në vitet e fundit 2023 dhe 2024 nga 500 qenë i kemi trajtuar përmes metodës së kastrimit, sterilizimit dhe vaksinimit dhe më pas janë liruar në vendin apo territorin e tyre. Kërkoj nga komuna më shumë fushatë vetëdijësuese për qytetarët për vaksinimin e qenve, si dhe nga Policia bashkëpunim në trajtimin e këtij problem”, ka thënë mes tjerash Mehmeti. Dy qendrat kryesore, Drenasi qendër dhe Komorani si bashkësi ma e madhe, kemi fokusin më të madh sa i përket trajtimit të qenve dhe gjendja është e mirë. Edhe togeri Florim Geci nga Policia theksoi se shqetësime ka po raste nuk kemi. Nënkryetari Shala theksoi se si komunë çdo herë e ripostojnë numrin e veterinerit Shaban Mehmeti në mënyrë që qytetarët të jenë në dijeni dhe ta kontaktojnë nëse kanë problem me qenë endacak.

Të ndryshme: Te pika të ndryshme nuk ka pasur ndonjë temë të veçantë, por anëtari nga EVSB, Arben Nika ngriti shqetësimin që tash në sezonin e dimrit mund të ketë vërshime dhe që Drejtoria për Emergjencë dhe Drejtoria për Infrastrukturë Lokale të jenë të përgatitur sa i përket rrjetit e ujërave të zeza dhe atmosferike pasi janë kryer shumë projekte dhe ndërtimet mund të kenë shkaktuar dëme në rrjet. Nënkryetari Shala theksoi se janë kryer investime në këtë rrjet brenda qytetit dhe në shesh dhe që kapaciteti i ri i përballon.

Procesverbali u përpilua nga koordinatori i KKSB-së:
Izveštaj pripremio Koordinator OOBZ: Laureta Thaqi
(emri, mbiemri dhe nënshkrimi / ime, prezime i potpis)

Procesverbali aprovohet nga Kryetari: Ramiz Lladrovci

Izveštaj odobrava Gradonačelnik:

[Signature]
Nënshkrimi / potpis

Data e aprovimit / Datum odobravanja: 15.11.2024

Rekomandimet:

- Dërgimi i këtij procesverbali është obligim që del nga UA 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL neni 11 pika 6;
- Procesverbali përpilohet nga koordinatori i KKSB-së në Komunën përkatëse;
- Procesverbali duhet të dërgohet në MPB në e-mail adresën: mpb.dsb@rks-gov.net
- Procesverbali duhet të dërgohet në MAPL në e-mail adresën: Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net

Procesverbali duhet të dërgohet njëkohësisht me ftesën e takimit të ardhshëm të KKSB-së.